



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"  
GJILAN



Komuna e Kaçanikut

Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Pranuar nga data 22-12-2020			
Nr. i Protokollit	Nr. i	Sh. i	Nr. i
	01/	2298	

Duke qenë se në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan janë në funksion të plotë dy drejtime studimore në kuadër të Fakultetit të Edukimit (Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor);

Duke qenë se Fakulteti i Edukimit ka një specifikë të veçantë për profilizimin e studentëve, që ka të bëjë me mbajtjen e mësimit praktik nëpër institucione shkollore dhe ato parashkollore,

Duke qenë se në Fakultetin e Edukimit në të dy programet i vijojnë studimet edhe studentët nga komuna e Kaçanikut, e të cilët rrjedhimisht do të ishte me e favorshme për ta mbajtura e mësimit praktik në institucionet shkollore dhe parashkollore në komunën nga vijnë;

E konsiderojmë të nevojshme të lidhim këtë

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

**Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan**  
të përfaqësuar nga rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

dhe

**Drejtorisë Komunale të Arsimit në Kaçanik**  
të përfaqësuar nga drejtori, z. Zahir Doda

### Neni 1

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan (UKZ), si entitet i ri i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, ka për qëllim të vendosë raporte bashkëpunimi dhe partneriteti me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Kaçanik (DKA), për të siguruar përmbushjen e planprogramit të Fakultetit të Edukimit, respektivisht pjesën programore përkritazi me komponentin e mësimit praktik, si dhe krijimin e lehtësirave për mbajtjen e mësimit praktik për studentë që vijnë nga komuna e Kaçanikut.

### Neni 2

Thelbi i kësaj marrëveshje nënkupton vënien në shërbim të resurseve profesionale të stafit mësimdhënës dhe të stafit udhëheqës të shkollave fillore dhe të enteve parashkollore, të cilat drejtohen nga DKA.

### Neni 3

Bashkëpunimi do të nënkuptojë pranimin dhe sistemimin e studenteve, për kohë të caktuar, në institucione shkollore dhe parashkollore dhe caktimin e mësuesve/edukatorëve në rolin e mentorëve për studentë që e mbajnë praktikën, duke u bazuar në planprogramet e Fakultetit të Edukimit, si dhe në Doracakun e mësimit praktik.

#### Neni 4

Duke e pasur parasysh që mësimi praktik është pjesë integrale dhe e detyrueshme e planprogramit të Fakultetit të Edukimit, interesi afatgjatë i UKZ-së, është që kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi dhe partneriteti të mos jetë e kufizuar, respektivisht, kjo marrëveshje të jetë efektive për aq kohë sa do të ketë programe të akredituara të Fakultetit të Edukimit nga ana e Agjencisë së Akreditimit të Republikës së Kosovës.

#### Neni 5

UKZ merr përsipër dhe pajtohet të përmbush detyrimet si në vijim:

- 5.1. UKZ të sigurojë përvoja të praktikës së mësimdhënies të një cilësie të lartë;
- 5.2. UKZ pajtohet që koordinatori i mësimit praktik të bashkëpunojë ngushtë me DKA-në, drejtorët e shkollave dhe enteve parashkollore, si dhe mësuesit/edukatorët mentorë për të siguruar që shkollat dhe entet parashkollore të jenë të informuara për politikave dhe procedurat e mësimit praktik.
- 5.3. UKZ pajtohet që të sigurojë që mësimdhënësit e Fakultetit të Edukimit do t'i mbikëqyrin studentet gjatë mbajtjes së mësimit praktik sipas politikave të mësimit praktik të parapara me Doracakun e mësimit praktik.
- 5.4. UKZ pajtohet të sigurojë që mësimdhënësit mbikëqyrës do të bashkëpunojnë ngushtë me mësimdhënësit dhe edukatorët mentorë, për të siguruar që ngritja profesionale e studentëve të jetë e udhëzuar dhe e mbikëqyrur sipas politikave të Fakultetit të Edukimit.

#### Neni 6

Drejtoria Komunale e Arsimit në Kaçanik merr përsipër dhe pajtohet të përmbush detyrimet si në vijim:

- 6.1. DKA pajtohet që të vë në dispozicion resurset njerëzore dhe resurset materiale që i ka nën menaxhim për studentët dhe mbikëqyrësit e tyre nga Fakulteti i Edukimit, me qëllim të realizimit të mësimit praktik të paraparë me skemën programore të Fakultetit të Edukimit.
- 6.2. DKA pajtohet që të vë në dispozicion, për t'i mentoruar studentet drejtpërdrejt në klasë, të gjithë rrjetin e mësuesve/edukatorëve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, si dhe ata që do të certifikohen në të ardhmen.
- 6.3. DKA pajtohet të sigurojë që drejtorët e shkollave dhe enteve parashkollore të tregojnë gatishmëri për t'i pranuar studentët e sistemuar, të caktuar nga Fakulteti i Edukimit për të mbajtur mësimin praktik në institucionet që janë nën menaxhimin e tyre.
- 6.4. DKA pajtohet që të sigurojë që drejtorët e shkollave dhe enteve parashkollore të luajnë rolin përkrahës në ofrimin e mbështetjes rreth organizimit të mësimit praktik dhe të lehtësojnë bashkëpunimin e mësimdhënësve mbikëqyrës nga Fakulteti i Edukimit dhe mentorëve në shkolla dhe ente parashkollore.

#### Neni 6

Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Gjilan, më 22.12.2020

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI-ZEKA", GJILAN  
Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Rektor

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT, KAÇANIK  
Z. ZAHIR DODA

Drejtor